

Afati i ankesave dhe trajtimi

Faza e parë e konkursit është përmbyllur më datë 27 gusht 2025, ku zyrtarët e Burimeve Njerëzore kanë pasur për detyrë të verifikojnë nëse dokumentacioni i dorëzuar përputhet me kriteret dhe kërkesat e konkursit të shpallur.

Në rastet kur është vërejtur mungesë e dokumenteve të nevojshme apo mospërputhje me kriteret e përcaktuara, kandidatëve u është lëshuar vendim refuzimi, i cili u është dërguar individualisht përmes emailit me të cilin kanë aplikuar, në këtë vendim është përfshirë edhe arsyeja e refuzimit të aplikacionit.

Bazuar në Udhëzimin Administrativ në fuqi, kandidatëve u është ofruar e drejta për ankesë brenda afatit prej 3 ditësh. Rrjedhja e afatit fillon nga dita e nesërme në përputhje me nenin 81 pika 2 dhe 4 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Gjatë fazës së ankesave, të gjithë aplikuesit që nuk janë të kënaqur me rezultatet ose me vendimin për refuzim të marrë nga zyrtarët e Burimeve Njerëzore, kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë. Ankesat mund të përfshijnë pakënaqësitë e tyre ose të mbështeten me dokumentacion për të dëshmuar të kundërtën e vendimit të marrë.

Ankesat dorëzohen në të njëjtën mënyrë si aplikimi – përmes të njëjtës adresë elektronike ku janë njoftuar me vendimin për refuzim të aplikimit – dhe adresohen tek Komisioni i përcaktuar për shqyrtimin e ankesave.

Komisioni i emëruar nga kompania do të shqyrtojë me kujdes të gjitha ankesat e pranuar brenda afatit të përcaktuar ligjor, dhe do të japë përgjigje për secilin rast, duke u bazuar në aktet në fuqi dhe dokumentacionin e dorëzuar nga aplikuesit.

Rok za žalbe i postupanje

Prva faza konkursa je završena dana 27. avgusta 2025. godine, gde su službenici za ljudske resurse imali zadatak da provere da li dostavljena dokumentacija ispunjava kriterijume i zahteve objavljenog konkursa.

U slučajevima kada je primećen nedostatak neophodnih dokumenata ili neusaglašenost sa utvrđenim kriterijumima, kandidatima je izdato rešenje o odbijanju, koje je pojedinačno poslato putem elektronske pošte kojom su se prijavili. U ovom rešenju je navedena i obrazloženje odbijanja prijave.

Na osnovu važećeg Administrativnog uputstva, kandidatima je ponuđeno pravo na žalbu u roku od 3 dana. Rok počinje da teče narednog dana, u skladu sa članom 81, stavovima 2 i 4 Zakona o opštem upravnom postupku.

Tokom faze žalbi, svi kandidati koji nisu zadovoljni rezultatima ili odlukom o odbijanju donetom od strane službenika za ljudske resurse imaju pravo da podnesu žalbu. Žalbe mogu sadržati njihovo nezadovoljstvo ili mogu biti potkrepljene dodatnom dokumentacijom u cilju osporavanja donete odluke.

Žalbe se podnose na isti način kao i prijava – putem iste elektronske adrese preko koje su obavešteni o odbijanju prijave – i adresiraju se Komisiji određene za razmatranje žalbi.

Komisija koju imenuje kompanija će pažljivo razmotriti sve žalbe primljene u okviru zakonski utvrđenog roka i odgovoriće na svaki pojedinačni slučaj, oslanjajući se na važeće akte i dokumentaciju dostavljenu od strane kandidata.